

DËSH TAKU

Fjodor Dostojevski

SEMION ARDALIONOVIÇI para tri ditësh më tha: 'Ivan Iliç! A ke ndër mend që të bëhesh ndonjëherë i mençur?'

Ja, këtë do të bëje mirë të ma thoshe, të lutem shumë.

Kërkesë e çuditshme ishte, por nuk ia mora për keq. Kam një natyrë prej njeriu të druajtur, kur do ti, më shpallën të çmendur!

Ja si ndodhi: një piktor provoi të më bënte portretin, ndodhi rastësisht. "Sidoqoftë, ti paraqet interes për mua, sepse je njeri i

letrave," - më tha. Pranova. Ma bëri portretin dhe më ekspozoi. Lexoj diku fjalët: "Shkoni që të shihni një fytyrë njeriu të sëmurë, që një hap e ndan nga çmenduria."

Le të shkruajmë. Merakun e kam tjetërkund... Po pse e denjë qenka për shtypin të merret me kësi konstatimesh? Se shtypi e ka për detyrë të merret me fisniken e fisnikëruesen, ai nuk bën dot pa ideale, kurse këtu...

Të paktën të thuheshin gjërat me dorashka. Se gazetarit pena prandaj i është dhënë. Po jo, parapëlqen thënien troç të gjërave! Po vë re që humori dhe fjala për të qenë kanë filluar të vdirren, kurse sharjet dhe sikterisjet po mbahen për mendjemprehtësi gazetareske. Nuk është se më fyen ato fjalë, se kushedi nukjam, këtë e di, nuk kam pse më hyn vetja në qejf, por të më shpallin të çmendur!... Shkrova një novelë, nuk ma botuan. Shkrova një fejtun, nuk ma pranuan. Atëherë ua shpërndava organeve të shtypit, lashë nga një kopje në çdo redaksi, nuk e botuan. Provova të shkruaj dhe të tjera, asnjë nuk ma botuan. "U mungon kripa!" - më thanë.

-E ç'kripë u dashka? - i pyeta me shpoti. - Mos nga ajo e Atikës?

E vura re që nuk e kuptuan shpotinë. Merrem me përkthime nga frëngjishtja, ua shes tregtarëve. Shkruaj dhe tekste reklamash me porosi të tregtarëve. Ja: "Blijeni çajin e kuq! Ka shije të rrallë! Vjen te ju drejt e nga plantacionet!" Me rastin e vdekjes së të ndierit, lartmadhërisë së tij Piotër Matvejeviçit, më porositën një fjalë përshpirtjeje. E po, mora një dorë para, nuk ishin pak. Njërin shkrim e titullova: "Arti për t'iu pëlqyer zonjave." E shkrova me porosinë e një librari. Deri më sot kam shkruar nja gjashtë të këtij lloji. Vendosa që t'i përkushtohem nxjerrjes në dritë të përmbledhjes "Bons mots", do të ketë shprehje fluturake dhe sentenca mendjempërçta të Volterit, por kam frikë mos do të thonë: "U mungon kripa!" E ç'Volter zeza në këtë kohë që erdhi! Edhe dhëmbët e fundit që u kishin mbetur, ua rrëzuan njëri-tjetrit gjatë përlëshjeve dhe kacafytjeve! Ja, kjo është veprimtaria ime letrare... E ç'të përmend tjetër? Mos nuk do të ishte keq që të zija në gojë dhe letrat që shpërndaj falas nëpër redaksi me nënshkrimin tim të plotë poshtë? Janë të mbushura me udhëzime dhe me porosi të dobishme e të nevojshme, bëj kritika, rrëfej rrugët, nëpër të cilat lypset të ecet. Javën që shkoi, në njërin prej redaksive dërgova letrën e dyzetë, kaq u kam dërguar gjatë dy yjetëve. Vetëm për pulla poste kam shpenzuar katër rubla. Arrita në përfundimin se fajin ma ka karakteri im i keq.

Për mendimin tim, piktori tregoi interes që të më bënte portretin jo ngaqë jam letrar, por sepse kam në ballë dy nishane krejt të njëjtë, të vendosur në një simetri të habitshme. "Dukuri e rrallë për të mos thënë e jashtëzakonshme!" - kështu u shpreh zotëria. Se këta të sojit të tij, meqë u mungojnë idetë, sulen si të çartur pas dukurive. Në portretin tim nishanet janë të arrirë, nuk kanë asnjë të sharë, këtë ata e quajnë realizëm. Kurse që më shpallën të çmendur, nuk jam vetëm unë, vitin e kaluar shumë nga të dorës sime i shpallën të çmendur. Dhe me çfarë motivacioni e bënë më pyesni? "Duke zotëruar një talent të mirëfilltë... më në fund, u sqarua... veç prej kohësh duhej parashikuar..." - kështu shkruan. Nuk është gjetje e keqe kjo e tyre! Po ta shohësh me syrin e artistit, kuptohet, të dorës së tyre, duhet lavdëruar. A e dini se ku rrahin? Duke na shpallur ca si ne, që kemi dalë me pretendime krijuese, të çmendur, pandehin se ua bëjnë të ditur të tjerëve që vetë ata janë të mençur. Nuk i kursejnë shpifjet për shpalljen e të çmendurve.

Për mendimin tim, më i mençur nga të gjithë është ai, që të paktën një herë në muaj e

shpall veten budalla. Është një zotësi e padëgjuar në ditët tona! Më përpara, budallai, të paktën një herë në vit, e dinte që ishte budalla, kurse sot nuk e di! Dhe e kanë ngatërruar aq keq këtë punë, saqë budallain nga i mençuri nuk e dallon dot. E bëjnë me qëllim.

Më kujtohet një shprehje mendjemprehtë spanjolle për francezët, që dy shekuj e gjysmë të shkuar ngritën çmendinën e parë në vendin e tyre. "I mbyllën që të gjithë budallenjtë në çmendinë, që të besohej se të gjithë të mbeturit ishin të mençur." Ashtu është: nuk ke si ua vërteton të tjerëve që je i mençur duke mbyllur dikë në çmendinë. "Filani u çmend, ne që mbetëm jemi të mençur." Jo, aspak nuk është kështu.

Por në djall vafshin... Edhe unë me këtë mendjen time sikur po e telendis ca si shumë veten! Pshim i panevojshëm është, po ta shohësh esëll. Edhe shërbëtores i mërzhitesh. Ja, mbrëmë më erdhi një mik. "Ka filluar të ndryshojë stili i të shkruarit, - më tha. - Stili po copëzohet. Po e copëtojnë pa pikën e mëshirës frazën... Futin në të fjali të ndërmjetme, pastaj brenda fjalisë së ndërmjetme futin një tjetër të ndërmjetme, pastaj ndërkillin dhe një fjali në kllapa, bëjnë si bëjnë dhe rrasin dhe një fjali, kuptohet, pa vend, dhe kështu pambarim..."

Miku kishte të drejtë. Po vë re që edhe me mua po ndodhin dukuri të çuditshme: po më ndryshon karakteri, po më dhëmb e po më ther koka, kam filluar që të dëgjojë ca zëra enigmatikë, më bëhet se më flet dikushi që më është pranë i padukshëm, por që unë e ndiej praninë e tij. Nga të katër anët dëgjoj të më' thonë: "Dështak, dështak, dështak!" E ç'dështak qenkam! Vetëm më duhet që ta largoj mendjen dhe kaq.

Dola që të shkrydhesha ndopak, por ja që u gjenda në një varrim. Kishte vdekur një fisi im i largët, Kolezhski e kishte emrin, një ish-këshilltar shteti. La pas vejushën me pesë vajza, që të gjitha të pamartuara. Vetëm me këpucë nuk ua del dot, pale pastaj me të tjerat. I ndjeri bënte si bënte, hiqe mos e këput ia shpinte, po vejusha mjerane si do t'ia bëjë, mbeti pa asnjë të ardhur, do të detyrohen që ta mbajnë frymën vetëm me pensionin e të shoqit. Do të heqin të zitë e ulhrit. U shkova për ngushëllim, më pritën si gjithmonë thatë, pa pikë përzemërsie. E dija, as këtë herë nuk ma kishte ënda që t'u shkoja, po ja që m'u duk e domosdoshme vajtja, thashë me vete: "Gjaku nuk bëhet ujë..." U rreshtova dhe unë përbri të tjerëve, e përcollëm në rrugën e fundit. Më ra në sy që kush më shihte, kthente kokën mënjanë: rrobat që kisha veshur ishin për ibret. Ç't'ju tregoj: m'u bënë nja njëzet yjet që nuk më kishte shkelur këmba në varrezë. Por vendi ishte për të qenë, vend për kokën e vendit!

Nja pesëmbëdhjetë i sollën menjëherc. Arkivole të çmimeve të ndryshme të zinin sytë, ndër ta u shquan dy katafalkë të shtrenjtë, njëri ishte i një gjenerali, kurse tjetri ishte i një zonjç të shoqërisë së lartë. Binin në sy ca fytyra të përzishme, ca të tjera shtireshin si të përzishme, por më shumë kishte fytyra të gëzuara, disave u buiste jashtë hareja e ngazëllimi. Ceremonitë nuk kishin të sharë, fitimet ishin fitime. Kurse ajri! Ah! Nuk do të dëshiroja të shërbeja në mjediset kishtarë!

Fytyrat e të vdekurve i shihja shkarazi dhe me bishtin e syrit, mbahesha i druajtur, sepse më trembte përshtypja e llahtarshme që do të më mbetej në kujtesë dhe do të më fanitej kudo që të isha. Se fytyrat e të vdekurve shprehin butësi dhe paqëtim, por ka dhe nga ato, që u kanë ngrirë ngërçet aspak të këndshme në grahmat e fundit. Ngërdheshjet e njerëzve, në përgjithësi, nuk janë të mira, ato të kufomave aq më keq. Druhem se do të më faniten në ëndërr ato që pashë.

Pas fafjes së përshpirtjes, dola nga kisha në ajër të pastër. Dita ishte bojë hiri, por e thatë dhe pa erë, ishte një ditë e rëndomtë tetori. Eca nëpër rruginat e varrezës. Më zunë sytë kategori të ndryshme varresh, kategoria e tretë kushtonte tridhjetë rubla, çmim i arsyeshëm. Kurse dy kategoritë e para ishin me spec, kuptohet, nuk qenë për të sërës sonë. Këtë herë të kategorisë së tretë varrosën gjashtë të vdekur, kurse gjeneralin dhe zonjën e shoqërisë së lartë i varrosën me arkivole të kategorisë së parë.

Pashë gropat e hapura, që prisnin arkivolet: tmerr, ishin plot me ujë dhe çfarë uji! Jeshil!... E çë pastaj? Varrmihësit po e nxirrnin me kova. Dola nga varreza për ta davaritur llahtarin dhe dëshpërimin që më pushtoi, u largova që aty për ta marrë pak veten, duke qëndruar sa më larg atij vendi. Aty pranë gjendej një azil, pak më tutje ishte një restorant, kishte ç'të haje e ç'të pije. Dhe nuk ishte keq. U mblodhën shumë, të gjithë kishin përcjellë të vdekurit në banesën e fundit. Më ra në sy gëzimi i tyre i papërmbajtur dhe galdimi i mirëfilltë, m'u dukën të sinqertë në ato që thoshin dhe bënë. Hëngra dhe piva sa desha bashkë me të tjerët.

Pastaj u rreshtova pranë grupit të përcjellësve që do të mbanin arkivohn. E çuam nga kisha në varr. E pse, vallë, të vdekurit janë kaq të rëndë? Thonë për inerci, sepse trupin tani askush nuk ua drejton, ai lëshohet krejt. S'e di të vërtetën, gjepura të tilla më kanë zënë veshët... Në kundërshtim me ligjet e mekanikës është, por edhe mendimi esëll nuk e honeps këtë palo arsytim. Nuk më pëlqen kur ca që kanë vetëm arsim të mesëm hidhen e flasin për çështje specialitetesh, e pra, ndër ne është një dukuri e rëndomtë. Civilët kërcejnë si kacagjela dhe flasin të çakërryer deri sa ngjiren për çështje ushtarake; inxhinierët krekosen me dijet, që shpalosin nga fusha e filozofisë apo e ekonomisë politike.

Në drekën e përshpirtjes nuk shkova. Jam tip sedërliu: e pashë që më pritën me përdhunë, e pse u duhej t'u bëhesha pleh edhe në drekë, qoftë dhe drekë përshpirtjeje. Vetëm një gjë nuk munda që ta kuptoj: përse vazhdova të qëndroja në varrezë pasi u larguan të gjithë. U ula poshtë njërit prej monumenteve dhe u zhyta në mendime.

Në fillim e çova mendjen tek ekspozita e Moskës, ku ai piktori vari dhe portretin tim, mandej ku nuk e bredhërova, përfundova te tema e habisë, që ndjen njeriu. Në këtë të fundit, "temën e habisë" ja se ç'ma rrokani kokën. M'u ndërmend arsytimi i dikujt: "Të habitesh nga gjithçka, që sheh, sigurisht, marrëzi është, kurse mos të të habit asgjë, kjo është shumë e bukur, pale që mbahet dhe e modës." Kurse mua nuk më duket se është kështu. Për mendimin tim, të mos habitesh prej asgjëje është marrëzi më e madhe se të habitesh prej gjithçkaje; pale pastaj që të mos habitesh prej asgjëje është njëlloj si të mos respektosh asgjë. Se ashtu është, marroku nuk ka si respekton gjë.

-Para së gjithash ma ka ënda që të respektoj. Ja që kështu jam prerë, dua shumë që të respektoj, - kështu më tha para disa ditësh një i njohuri im.

Dëshiroka me ashk zemre që të të respektoj, burri i dheut! O Zot! Po ç'do të ndodhte, vallë, sikur të arrije që ta botonin sot një të tiftë konstatimi, aq tepër kuturisës!

Tek përsiasja në kokë ca hamendësime të tilla, se si e humba mendjen. Nuk më pëlqen që të lexoj mbishkrime varresh, sepse të njëjtat fraza dhe të njëjtat formulime përsëriten.

Mbi pllakën e varrit, që kisha pranë, ishte një copë panine me qofte e pambaruar.

Marrëzi! Nuk duhej të ishte! E hodha në tokë, sepse ajo nuk ishte bukë, por ishte panine me qofte. Por s'ka gjë, edhe bukën në tokë shkërmoqe, nuk është gjynah, ta hedhësh bukën në dysheme është gjynah. Në kalendarin e Suvorinit kështu është thënë.

Duhet menduar të kem ndenjur gjatë, madje shumë gjatë, ashtu i zhytur në të thelia nën atë monument. Më kujtohet që u shtriva dhe mbi pllakën prej mermeri që mbulonte njërën prej varreve. Po si më ndodhi, që veshi po më zinte gjithfarë zërash, madje zura ta shkoqis dhe çfarë thoshin, këtë nuk e them dot. Në fillim nuk u kushtova kurrfarë vëmendjeje, madje qëndrova shpërfillës dhe përbuzës, por zërat vazhdonin të dëgjoheshin gjithnjë e më qartë, të thënat vazhdonin e vazhdonin... U detyrova që të mbaj vesh: tingujt vinin disi të mbytur dhe të shuar, por ishin lehtësisht të kapshëm, të krijohej përshtypja se folësit i kishin të bukosura gojët me jastëkë, por sidoqoftë dëgjoheshin, vinin deri tek unë qartë. E shkunda nga vetja hutimin dhe plogështinë, u ngrita ndenjur dhe dëgjova i përqendruar se ç'thoshin.

'Lartmadhëri! Kjo që jeni duke bërë nuk shkon! Sapo e shpallët që jeni duke luajtur me spathinjtë, ju përgjigja visto, kurse del që paskeni në dorë shtatë letra karë. Duheshin shpallur karetë.

'E ç'është kështu me ju? E pse u dashka luajtur me të shpallur? Po lezeti i bixhozit aty është, që ta befasojë tjetrin!

-Jo, nuk është e mundur, lartmadhëri! Pa paralajmërim nuk luhet! Po b'fiofi, atëherë, pse është?

-Po në nuk të vjen letra, atëherë si të bësh?...

Më bëri përshtypje vetëbesimi dhe fodulfëku, që i shoqëronin këto fjalë! Edhe po më habiste, edhe po më bcfasonte, kjo që po dëgjoja! Dukej që njëri zë i përkiste një njeriu me peshë, njërit të sferave të larta shoqërore, kurse tjetri ishte zë i butë, i shtruar, madje e disi i sheqerosur dhe që shprehte përlulësi. Po të më kishte treguar ndokush për një dukuri si kjo, nuk do ta besoja kurrën e kurrës, por ja që po i dëgjoja ata zëra me veshët e mi! M'u kujtua që në drekën e përshtypjes nuk shkova. Po kjo këtu ç'është? Si ishte e mundur që këta këtu luanin preferansë? Dhe njëri prej lojtarëve ishte gjeneral. Kurse që ata zëra vinin nga poshtë varreve, për këtë nuk kisha as dyshimin më të vogël. U përkula dhe lexova mbishkrimin në plfakën e mermertë të varrit.

"Këtu prehet trupi i gjeneraf-major Pervojedovit... kavafier i të tiftë e të atiftë

Urdhrave..." Hëm! "Ndërroi jetë në gushtin e vitit... pesëdhjetë e shtatë yjeç... Prehu, o njeri i mirë, deri në mëngjesin e ditës së ringjafles së madhe, të gjithëpërmbarshme." Dreq o punë! Vërtet gjeneral qenka!

Në varrin tjetër, nga ku vinte ai zë i butë dhe si i hekuros, aq i sheqerosur, nuk kishte plfakë mermeri, te koka kishte vetëm një si pezul për të ndezur qirinj. Dukej që ishte varr i ri. Nga zëri mund të gjykoje se nuk shkonte më larg se këshilltar oborri.

'Oh'oh'oh-oh! - u dëgjua një zë krejt i ri dhjetë a dymbëdhjetë metra më tutje, nën një varr fare të freskët. Ishte një zë njeriu të thjeshtë, por që nxjerrësi e kishte dobësuar dhe ngjirur enkas, për t'u dukur sa më lajkatar.

'Oh'oh'oh-oh!

-Ah! Zuri dhe ky zavalli, ky belbacaku! - u dëgjua zëri qibërmadh dhe përçmues i zonjës së shoqërisë së lartë. Dukej e mlfefosur dhe e ndërkrayer. - Më paska dënuar Zoti që u gjenda përbri këtij dyqanxhiu!

-Po unë as po shtirem e as po Uastohem, si kam qenë ashtu jam. Të keqen gjejeni te vetja, zonjë. Janë huqet e vjetra ato që nuk ju lënë të ndiheni e qetë.

'E keqe e madhe më gjeti që ju kam pranë!

-Jam aty ku më vunë. Nuk u shtriva me dëshirën dhe vullnetin tim. U kujdes ime shoqe së

bashku me fëmijët. Edhe kjo që u ndodha këtu është një fshehtësi e vdekjes... Se të qe për mua, nuk do të doja kurrën e kurrës që të isha pranë jush. Do t'ju them dhe një gjë: jam këtu falë kapitalit të vënë, të mitë, sa u kërkuan, u dhanë për vendin. Jemi aq në gjendje sa të mos kursehemi për një rast si ky.

-Paratë që keni vënë janë djersa e të tjerëve, ua keni vjedhur me të dyja duart.

'E si u vjedhkan cave si ju! Merrni veresie që nga janari e vitin në vazhdim! Në dyqan e kemi defterin me llogarinë.

-Çfarë marrëzie që flet! Po pse, mor derdimen, a u kërkohet shlyerja e borxhit atyre që janë këtu? Shkoni atje lart, kërkojani mbesës se ajo është trashëgimtarja.

'E ku bëhet ajo tani! E si u shkuaka tani! Gjynahe ne kemi boll, përpara gjyqit të perëndisë do të përgjigjemi.

'Mos guxoni të më flisni për gjynahet!

'Oh'oh'oh-oh!

'E shihni lartmadhëri? Dyqanxhiu i vë veshin fjalës së zonjës dhe i kthen përgjigje. 'E pse të mos e bëjë?

-Jo po thashë, lartmadhëri. Sidoqoftë, këtu ka ca rregufla të reja.

'E ç'rregufla qenkan?

-Po ja, ne, si të thuash, tani jemi të vdekur, lartmadhëri. -Ah, po. Ama rregufiat mbeten rregulf a, gjithkund e për këdo janënjefloj...

S'ke ç'të thuash. Balsam për shpirtin tim të dështakut ishin këto që po dëgjoja! Dhe sjellja e këtyre që ishin këtu po ma ngrohte shpirtin. E ç'nuk ndodh në botën tonë, kudo që është, atje apo këtu. Vazhdova të dëgjojë zërat që nuk pushonin së ardhuri që brenda varreve, ndonëse nervat i kisha të kreshpëruara. Po më ziente përbrenda kazani i zemërimit dhe i mflëfit.

-Jo, de, jo! Doja të rroja! Po, po... unë doja të rroja! - u dëgjua një zë i ri diku ndërmjet gjeneralit dhe zonjës së pakënaqur nga fqinjësia me dyqanxhiun.

'E dëgjoni, lartmadhëri? Ky që kemi këtu pranë nuk heqka dorë nga e veta... Tri a katër ditë hesht, por pastaj përsëri të vetën tjerr... Jo do të desha të rroja! Jo më vjen keq! Dhe me çfarë oreksi që e thotë! Hi-hi-hi!

-Edhe me mendjelehtësi!

'I paska mbetur merak, lartmadhëri! Ka që në prill këtu. Rri-rrri i tulatur, i dremitur, kur befas e dëgjon të thotë: "Do të desha që të rroja!"

-Të kall mërzinë, - vuri në dukje lartmadhëria.

-Po, vërtet, mirë thoni, lartmadhëri. Të mërzit me ato që thotë. Mos duhet ngacmuar përsëri Avdotia Ignatievna?... Hi, hi, hi!

-Jo, jo! Sa më larg saj, më mirë! Nuk e duroj dot atë kërkëllitëse zevzeke!

-Përkundrazi, jam unë ajo që nuk ju honeps dot që të dyve ju atje! - ua ktheu me neveri e përbuzje kërkëllitësja zevzeke. - Uh! Sa të mërzitshëm që jeni! Asgjë ideale, të lartësuar, për shpirtin, nuk dini që të tregoni, sepse nuk i keni! Ju, lartmadhëri, mos m'u fryni e as m'u ngrëfosni ashtu! Di një histori që ju ka ndodhur: shërbëtori ju ka nxjerr me bishtin e fshesës që poshtë krevatit të një zonje...

-Çfarë gruaje lapërdhare! - nëpërdhëmbi me përçmim gjenerali.

-Moj nënë, Avdotia Ignatievna! - u dëgjua befas përsëri zëri i dyqanxhiut. - Zonjë e nderuar! A s'më thoni, duke e lënë mënjanë ligësinë, mos do të më duhet që të eci nëpër

rrugën e mundimeve? Apo ç'gjë tjetër më pret?

-Ah! Një avaz di ky kokëdruth! E parandjeva që kështu do të ndodhte! Që andej, prej atij, më vjen ajo duhmë e keqe! Dhe kutërbon, ngaqë nuk rri dot i qetë, por vërtitet mos më keq, mjerani!

-Nuk po vërtitem, moj nënë! As erë të keqe nuk mbaj! Që kur më varrosën, ruhem dhe jam krejt i paprishur. Kurse ju, zonjë, sikur jeni tretur cazë... Ja, nga ju përhapet duhma e keqe, e padurueshme... Meqë prej natyre jam i sjellshëm, kam heshtur, nuk kam dashur që t'ju lëndoj.

-Ah! Sa gojëprishur që jeni! Sa i lig që po tregoheni! Kutërbimi i padurueshëm vjen prej teje, kurse ma hedh mua...

-Oh-oh-oh-oh! Mezi po pres që të më vijnë të dyzetat! Do të dëgjoj zëra të përлотurish sipër meje, vajin e time shoqeje, qarjenefëmijëve!...

-Ja se ç'kërkoka trushkuluri! Do të denden me atë grurin e përsphirtjes dhe do të largohen! Ah! Sa mirë do të ishte sikur të zgjohej ndonjë tjetër!

-Avdotia Ignatievna! - u dëgjua zëri i nëpunësit lajkatar. -Bëni pak durim, do të zënë të flasin edhe më të rinjtë.

-Po djelmosha a ka në mes tyre?

-Edhe të rinj ka, Avdotia Ignatievna. Ka dhe fare të rinj në moshë.

-Ah! Sa mirë do të ishte!

-Po pse nuk filluakan të flasin? - kërkoi të dinte lartmadhëria.

-As ata që i mbushën tri ditë nuk janë zgjuar, lartmadhëri. Ju e dini, ndonjeherë kalon java dhe nuk flasin. Mirë që sollën dje dhe para dy ditësh të rinj. Se në largësinë mbi dhjetë metra janë ata të vitit të kaluar.

-Po, po.

-Ja, lartmadhëri. Sot varrosën këshilltarin e fshehtë Taraseviçin. Përcjellësit i njoha nga zëri, nipin e tij e di kush është, ai e lëshoi në gropë arkivolin.

-Hëm! Po ku është?

-Jo më shumë se pesë hapa larg jush është, lartmadhëri. Do ta ketë për nder fatin e mirë që e vunë pranë jush. Nga e majta juaj ndodhet. Fare pranë këmbëve e keni... Sa mirë do të ishte sikur të zinte të fliste dhe të njiheshit, lartmadhëri.

-Hëm! Gjë që s'bëhet... Duhet që të më flasë ai i pari... Ndryshe priset...

-Po, sigurisht, lartmadhëri, që do të jeta ai që do t'ju flasë i pari... Do ta ketë për nder që ta bëjë... Ma lini këtë punë në dorë mua, lartmadhëri... Di unë si...

-Ah! Ah! Po kjo ç'është? Ç'është kështu me mua? - tha permes psherëtimash dhe ofshamash një zë i ri, i trembur.

-Një i ri, lartmadhëri. Një i ri foli. Sa shpejt që foli! Të tjerët, ata që janë këtu përpara tij, edhe pas një jave mezi zënë që të flasin.

'M'u duk zë djaloshi njomëzak! - kërkëlhti që aty ku ishte Avdotia Ignatievna.

'Unë, unë nga një komplikacion... Aq papritur e pa kujtuar! -belbëzoi djaloshi. - Doktor Shulci në darkë më tha se po më fillonte një komplikacion, në mëngjes vdiqa. Ah!

-Nuk ke ç'të bësh, djalosh, - i foli me zë të mallëngjyer dhe të përmortshëm gjenerali që, me sa dukej, u gëzua që zuri të fliste një i ri. - Ç'kishte për të ndodhur, ndodhi. Mirë se vini, si të thuash, në këtë shtëpinë tonë të madhe. Njerëzit këtu janë të mirë, do t'i njihni dhe do t'i çmoni. Ju paraqitem: gjeneral-major Vasil Vasilieviç Pervojedovi. Gëzohem që po ju njoh.

-Ah! Jo, jo, jo! Ju thashë, më vizitoi doktor Shulci, më ndodhi komplikacion, m'u bflokua kraharori, më mbyti kolfa, zjarrmia... pas kësaj krejt papritur... Po, po! Krejt pa pritur e pa kujtuar...

-Thatë se në fiftim ju bllokua kraharori, - saktësoi me zë të butë e tërë mirësjelfje nëpunësi. Dukej që donte t'i jepte ndopak zemër të riut të pikëlluar.

-Po, po... Gjoksi... Pastaj koila... Pas këtyre as gjoksi e as kofla, nuk merrja dot frymë... Dhe e dini?...

'E di, e di. Po në ju qenka bllokuar gjoksi, atëherë duhej që t'ju vizitonte doktor Eku e jo doktor Shulci.

-Desha të vizitohesha te doktor Botkini... kur befas...

-Botkini të rrjep lëkurën, - vuri në dukje gjenerali.

-Jo, pse, nuk ta rrjep... Për të flasin mirë, thonë se është shumë i kujdesshëm.

-Lartmadhëria e pati fjalën te çmimi, domethënë, i ka vizitat të shtrenjta, - e sqaroi djaloshin e pikëlluar nëpunësi.

-Çmimi? Pse? Tri rubla vizita. Ama, të sheh mirë, recetën ta jep recetë... E ndava mendjen t'i vija... Po ju, zotërinj, si më këshilloni, ku është më mirë që të vete, te doktor Eku apo te doktor Botkini?

-Si? Ku? - u gajas së qeshuri gjenerali, kufoma zuri që t'i përkundej e valëzohej. Nëpunësi lëshoi ca piskama për t'i mbajtur isongjeneraht.

-Sa djalë i mirë qenke! Naiv te Zoti qenke! Na bëre për të qeshur! Djalë për t'u dashur qenke! - kërkëlliti që aty ku ishte Avdotia Ignatievna. - Ah! Sikur ta kisha këtu pranë një të tillë!...

E po, tek shkoi deri këtu puna, këtë nuk kishe si e lejqsje! E kush po i thoshte ato fjalë, pa? Një që kishte vdekur ditët e fundit! Po s'kishe ç'të bëje, duhej dëgjuar. Nuk duhej nxituar me përfundimet. Djalin që sapo zuri të fliste e kisha parë dje, i kishte ngrirë në fytyrën shafran të verdhë shprehja e zogut të trembur, pamje më të pështirë nuk gjeje! Por të dëgjojmë më tej ç'do të thuhet.

U bë një krahurë që nuk munda t'i ruaja në kujtesë të gjitha ç'u thanë. U zgjuan në një kohë shumë: foli nëpunësi, foli këshilltari i oborrit, i foli gjeneralit për atë nënkomisionin e ngritur brenda përbrenda ministrisë, për lëvizjet e detyruara që priteshin të bëheshin në radhët e zyrtarëve. Gjenerali u përfshi me zjarr në bashkëbisedimin me të. Të them të drejtën, mësova të dhëna të reja lidhur me funksionimin e administratës sonë. Pastaj u zgjua, ndonëse jo plotësisht, një inxhinier, ashtu torromeza, dërdëlliti gjatë gjepura, prandaj askush nuk ia vari trastën, thanë ta dëgjonin si të zgjohej mirë dhe të merrej vesh se ç'donte të thoshte e ku donte të dilte. Më në fund, dha shenja gjallërimi varri fare pranë zonjës së lartë, atë që prehej aty e varrosën këtë mëngjes. Lebeziatnikovi (sepse nëpunësilajkatar, këshilltari i oborrit, ai, të cilin po e urreja për sjelljen prej sahanlëpirësi që e kishte në gjak dhe që ndodhej pranë gjeneral Pervojedovit, doli se e kishte ernrin Lebeziatnikov) nuk po gjente vend ku të futej, habitej dhe çmeritej që këtë herë po zgjoheshin aq shpejt. Të them të drejtën, edhe unë vetë po habitesha, ndonëse disa prej të zgjuarve kishin vetëm tri ditë që ishin varrosur, siç ishte, bie fjala, vashëza njomëzake, gjashtëmbëdhjetëvjeçare, që tërë kohën kukuriste... kukuriste me ligësi të shfaqur që i shtohet edhe për shkak të epshit të panginjur.

-Lartmadhëri! Po zgjohet këshilltari i fshehtë Tarasaveçi! -njoftoi befas Lebeziatnikovi. Të dukej sikur nxitonte për diku.

'Ë! Ç'është! - nëpërdhëmbi me përbuzje, si duke shkroftitur këshill tari i fshehtë. Dukej që ende s'kishte ardhur mirë në vete. Në zërin e tij u dëgjua fodullëku dhe toni urdhërues. Mbajta vesh, m'u ngacmua kureshtja, qëndrova në pritje të asaj që do të ndodhte. Kohët e fundit pata dëgjuar të flitej për Taraseviçin, ajo që kisha dëgjuar ishte sa mendjengritëse e mendjeprishëse, aq dhe shqetësuese e alarmuese në shkallën më të lartë.

-Jam unë, lartmadhëri! Jam unë, dora vetë.

-Ç'dëshironi? Me se mund t'ju shërbejmë?

-Dua vetëm një gjë: që të mësoj sa më parë si e ndjeni veten, lartmadhëri? Ngaqë nuk jeni mësuar ende me gjendjen e re, është afërmendsh që ta ndieni veten si të zënë ngushtë në këto rrethana... Gjenerali Pervojedov do të dëshironte që të njihej me ju. Shpreson se do të ketë nderin që të njihet me lartmadhërinë tuaj...

-Nuk më kanë zënë ndonjëherë veshët një emër të tillë. -Si qenka e mundur, lartmadhëri! E kemi fjalën për gjeneral Vasih Vasiheviç Pervojedovin... -Ju jeni gjeneral Pervojedovi?

-Jo, lartmadhëri, unë jam vetëm këshilltar oborri, zotëri, jam i gatshëm që t'ju shërbej.

Kurse gjeneral Pervojedovi...

-Gjepura! Do t'ju lutesha vetëm për një gjë: të më lini të qetë.

-Lëreni! - tha i mllfosur gjenerali dhe sakaq ia ndaloi Lebeziatnikovit komumkimin e mëtejshëm me të sapo zgjuarin.

-Ende nuk është përmendur si duhet, lartmadhëri! Duhet patur parasysh një gjendje e tillë, e ndërmjetme... Ende nuk është mësuar me gjendjen e re... Si të përmenden, si të shkrydhen ndopak dhe ta mbledhin mirë veten, do të jenë ata që do t'i thërresin mendjes dhe do ta kenë për nder, lartmadhëri... -Le të shohin punën e tyre, - përsëriti gjenerali.

-Vasili Vasilieviç! Hej! Lartmadhëri! - u dëgjua atë çast një zë i lartë, i çakërritur dhe që shprehte hakërrimë, por po aq dhe emocion. Ai që foli ndodhej fare pranë Avdotia Ignatievnës, dhe ishte një zë i ri, dukej që i përkiste një zotërie autoritar dhe disi inatçor, një kuturitësi moskokëçarës, por që përmbante dhe ngjyresa lodhjeje e shkrehjeje, siç ishte i pëlqyer dhe në modë të folurit në atë kohë, por që nxirrnin krye edhe disa si klithma-sfida, që shprehnin arrogancë dhe kryelartësi. - Kam dy orë që po mbaj vesh se ç'po bëhet... Është dita e tretë që jam këtu... A ju kujtohem se kush jam, Vasili Vasilieviç? Unë jam Klineviçi. Jemi parë te Vollokinskët. Nuk e them dot si e tek, por një gjë e them me plotgojen, edhe ju e keni patur derë shtëpinë e tyre. Ju kanë pritur e përcjellë si të vetin.

-Si? Pse konti Piotër Petroviçi jeni? A thua ju të jeni, zotëri i nderuar? Po si? Në një moshë aq të re!... Më yjen shumë keq!...

-Po, edhe mua më yjen keq, por nuk e çaj kokën... Të tillë natyre kam, që ma ka ënda të nxjerr përfitim, pavarësisht nga gjendja në të cilën ndodhem... Së pari, unë nuk jam kont, por baron. Jam vetëm baron. Na kanë thirrur baronë të shërbimit, por mua aq më ka pas bërë... Më kanë mbajtur për njeri të prapë dhe të paudhë ata të shoqërisë së lartë, më kanë pas vënë nofkën "çamarok zbavitës", por as kjo nuk më leqendis. Im atë ka qenë gjeneral, por nuk ka patur ndonjë peshë në shoqërinë e lartë, ime ëmë ka qenë si e shtëpisë në dyert më të shquara të aristokracisë. Vitin e shkuar, me ndihmën e çifutit Zifil, munda që të hidhja në treg pesëdhjetë mijë kartëmonedha false, çifutin e kapën, e paditën, kurse ai i mori paratë dhe ia mbathi për në Bordo të Francës, shkoi te Julia Sharpentier dhe Lysingeni. E merrni dot me mend, unë për pak sa nuk u fejova me Shevalska-jan, veç vogëlushja ende nuk i kishte mbushur të gjashtëmbë-dhjetat, donte dhe tre muaj, ishte

nxënëse shkolle. Për nëntëmbëdhjetë mijë gati ishte fejesa. Avdotia Ignatievna! A ju kujtohet se çfarë bëtë me mua pesëmbëdhjetë vjet të shkuara, kur isha pazhë oborri? Juve ma prishët virgjërinë!...

-Ah! Pse ti qenke, mor kolopuç? E po, paska bër emër Zoti që u gjende këtu, fare pranë meje! Ah! I qofsha falë! Po më mbyste mërzia! Ja që nuk qëllova e rrethuar nga njerëz për të qenë...

-Nuk bëtë mirë që dyqanxhiun, fqinj tuaj, e fyet ashtu atypari... Kot i thatë që mbante erë... Ju dëgjova me veshët e mi, por parapëlqeva të hesht... Vetëm se qesha me vete... Era del nga unë. E solla që andej nga erdha. Ashtu siç isha, i rënduar nga gjithë ato paudhësi e lapërdhi, më rrasën në arkivol dhe më sollën këtu, më varrosën...

-Ah! Çfarë ndyrraqi që po e tregoni veten! Sidoqoftë, gëzohem që ju kam pranë. As që mund ta besoni, Kiineviç, sa shumë që mungon jeta këtu, nuk të zë veshi as pikën e mençurisë e të mendjemprehtësisë.

-Po, po! E kam atë synim! Dua që të krijoj marrëdhënie origjinale këtu në mesin tonë. Lartmadhëri! Nuk po ju drejtohem juve, gjeneral, po i flas lartmadhërisë tjetër, këshilltarit të fshehtë, zotit Taraseviç. Përgjigjmuni, zotëri. Jam Klineviçi. A ju kujtohem? Unë jua rregullova njohjen me zonjushën Fyri. A më dëgjoni?

-Po, ju dëgjoj, Klineviç. Dhe gëzohem shumë që... Të më besoni...

-As dhe një çikë nuk ju besoj. Se mua as që më bëhet vonë... Do të desha që t'ju puthja në të dyja faqet, mor plakush i mirë, por ja që, lavdi Zotit, nuk mundem... Po a e dini zotërinj? A keni dëgjuar se ç'ka qullosur, llangosur thuaj, ky gjysh i nderuar?... Tri a katër ditë më parë ndërroi jetë, por a e përfytyroni dot se ky person që keni këtu la mangut në arkën e shtetit jo pak, por katërqind mijë rubla? Dhe ua la në qafë të vetëve, ata duhet ta shlyejnë deficitin e madh, vejusha së bashku me jetimët duhet që ta shlyejnë!... Kishte tetë vjet që me gjithfarë marifetesh i shmangej kontrollit, por një ditë të bukur iu hoqën petët byrekut dhe i dolën lakrat... Tani, zotërinj, a mund ta përfytyroni gjendjen e vejushës dhe të fëmijëve të rritur, kur morën vesh skandalin, deficitin e përmasave fantastike? E kuptoni vetë si e kujtojnë! Hë, zotërinj, a nuk është gudulisëse dhe skërmitëse që ta përfytyrosh? Vitin e fundit, tek e shihja, dhe vetë habitesha, se nga i gjente forcat ky mingo, nga i vinte gjithë ajo dëshirë për t'u marrë me lapërdhi dhe kurvëri një plaku aq të rrëgjuar, të zgërlaqur, që i kishte kapërcyer të shtatëdhjetat, dhe që vuante nga cerma, nga hemorroidet, nga astma dhe ku di unë nga ç'tjetër? Të mjerët jetimë! E mjera vejushë! Kurse unë isha në dijeni të të gjitha paudhësive të këtij njeriu, sepse m'i tregonte Sharpentieri. E dija me ç'merrej dhe çfarë bënte. Me ta nuhatur si e tek, iu përvodha me lajka dhe ledha, me fjalë njeriu dashamir. Një ditë të bukur, iu afrova dhe i shpafla: "O më jep në dorë njëzet mijë rubla, o nesër e ke këtu kontroflin e shtetit." E qartë, e kërcënova. Doli që nuk kishte më shumë se tridhjetë mijë, të tjerat i kishte faruar duke u dhënë pas lapërdhivë... Ama, një gjë ky e bëri mirë: vdiq bash në kohën e duhur, ndyrraqi! Gjysh! O gjysh! Po më dëgjon?

'I shtrenjti Klineviç! Jam plotësisht në një mendje me ju! Më kot i mëshuat gojës... u dhatë pas ca imtësive... Të tepërta qenë... Se jeta është e mbushur me aq shumë vuajtje dhe mjerim, është e mbushur dhe me mundim e sfiitje të mëdha, por njëherazi ka në të aq pak ndëshkim për paudhësitë!... Desha që të prehesha, ishte dëshira ime më e fundit, por, me ç'po dëgjoj e po marrë me mend, mund të them se dhe këtu u nxjerrkan përfitime...

-Çfarë be të zë, Taraseviç, që ende nuk e keni nuhatur se këtu pranë keni gjashtëmbëdhjetëjeçaren, Katishën epshore...

'E ç'Katishë? Ju për ç'Katishë po më flisni? - e pyeti me ca fërgëllima zëri, tërë neps dhe iakmi, plaku qejffi.

Ah! Dashkeni që ta njihni nga afër, ë? Për ç'Katishë e paskam fjalën, kështu po më pyetni? Po ja, fare afër e keni, nja njëzet hapa poshtë meje është, kurse që aty nga ju është gjithë-gjithë dhjetë hapa larg... Ka pesë ditë që është këtu. Ah! Sikur ta dinit, or gjysh, se ç'djallushë qejflie që është! Dhe vjen nga derë e mirë, di të sillet me edukate, di të spituffohet, ama, edhe si monstër s'e ka shoqen! Monstër e fjalës më të fundit është! Atje askujt nuk ia pata treguar, vetëm unë e dija se kush ishte dhe si ishte. Katishë, kuje?

-Hi'hi'hi! - u dëgjua kukurisma e një zëri të troshitur dhe të ngjirur, erdhi pak i mbytur, por edhe në atë shurdhim ndihej ngacmimi i zërit vajzëror, ndihej të shpuarit si gjilpërë i tij. - Hi-hi-hi!

-Mos je gjë ffokëverdhe? - këngëzoi sakaq, i ngjirur dhe gjoksor, i ndërprerë prej shkulmesh epshi, zëri i plakushit të zgërlaqur.

'Hi-hi'hi!

-Ka kohë... ka kohë... - belbëzoi i shuar, i rrufitur nga shkulmet ndjellëse të epshit, plakushi, - që e ngroh në shpirt ëndrrën për një flokëverdhe... Ka pesëmbëdhjetë yjet... Dhe ja, pikërisht në ca rrethana të tilla...

-Ah! Çfarë përbindëshi! Çfarë monstre! - kfithi që aty ku ishte Avdotia Ignatievna.

-Mjaft! - urdhëroi me zë të prerë Klineviçi. - Po e shoh që plaçka e këtushme nuk paska të sharë! Më mirë, priset! Do të rreguUohemi si s'ka më mirë! Kryesorja, do të kemi me se të argëtohem, si ta kalojmë kohën duke u zbavitur. Hej! Ju atje! Lebeziatnikov! Dëgjova sikur me këtë emër ju thirrën.

-Po, Lebeziatnikov Semion Evsejeviç më quajnë, mbaj titullin e këshilltarit të oborrit. Jam në shërbimin tuaj, zotëri. Gëzohem shumë që u njohëm.

-M'u prish gjiza mua në jeni i gëzuar apo nuk jeni!... Po më dukeni njeri i vënë në dijeni për gjithçka. Dua t'ju pyes (kam dy ditë që nuk po i jap dot dum): si është e mundur që ne këtu flasim? Se ne vdiqëm, kurse për të folur flasim, më duket se edhe lëvizim, kurse në të njëjtën kohë ne as flasim e as lëvizim dot?... Po këta numra ç'janë?

-Në dëshirokeni që ta dini se ç'është kjo kështu, zoti baron, jua shpjegon më mirë se unë Platon Nikollajeviçi.

'E kush na qenka ky Platon Nikollajeviçi? Mos dërdëllitni gjepura, por kur ju pyesin, përgjigjuni pyetjes që ju bëjnë...

-Platon Nikollajeviçi, zotëri, është një filozof i moçëm, është si i shtëpisë këtu mes nesh, ka studiuar shkencat, mban titullin e magjistrisë. Ka botuar disa libra në tema filozofie. Po ja që prej tre muajsh e ka pllakosur gjumi dhe tani është e pamundur që ta zgjosh. Vetëm një herë në javë seç mëmërit, si vetë me veten dërdëUit, thotë disa fjalë zor të kuptueshme, por edhe kot së koti flet, për gjëra që nuk kanë të bëjnë me çështjen që ju intereson.

-Do të bënit mirë t'i përgjigjeshit baUazi pyetjes që ju bëra!

-Mos ma dridhni Uafin!

-Po ja, ky filozofi, Platon Nikollajeviçi, e shpjegon dukurinë, për të cilën po më pyesni, kështu: kur rronim atje lart, e paskemi quajtur gabim vdekjen e tanishme. Këtu trupi, si të

thuash, gjallërohet përsëri. Mbetjet e asaj jete përqendrohen, por vetëm se kjo bëhet në vetëdijen tonë. Nuk di si t'jua shpalos gjatë e gjerë shpjegimin, vetëm se një gjë mund t'jua them saktë: jeta këtu vazhdon, si të thuash, për inerci, si jetë në vetëdijen tonë. Sipas asaj që pohon Platon Nikollajeviçi, diku thellë në vetëdijen tone jeta vazhdon edhe disa muaj, mund të shkojë deri një gjysmë viti... Ja, është njëri këtu, të cilit i kanë mbetur vetëm kokcat, por një herë në gjashtë javë, edhe ai seç dërdëllit, nxjerr ca fjalë të shkëputura, kuptohet, që nuk e merr dot vesh se ç'thotë, ama, njëren fjalë ai e përsërit shkoqur: "Dështak, dështak!" Pra, siç e kuptoni dhe vetë, vetëdija e tij vepron me forcën e atjeshme, në rastin e dhënë, ajo është vetëdija e dështakut. Pra, del që edhe në eshtrat gëluaka jetë, si një shkëndijë e padukshme duhet të jetë...

-Shpjegim prej budaUai na bëtë! Po kësaj ç'i thua zotëria jote? Edhe duke mos patur nuhatje, unë e ndiej kutërbimin.

-Kjo... he, he... Në këtë pikë filozofi ynë u tregua i errët, i mjegulluar. Pikërisht lidhur me nuhatjen ai vuri në dukje se, në këtë mjedisin tonë ndihet, si të thuash, kutërbimi moral... He-he... Është kutërbim shpirti... Ai kutërbim, duam ne apo nuk duam, detyrimisht do të vërtitet këtu, në mesin tonë, ndër ne, tre a katër muaj, i duhet, si të thuash, që të mbledhë veten... Tha se qenka mirësia e fundit që u shprehka... Kurse mua, zoti baron, më duket se këto dërdëllitje të filozofit nuk janë tjetër vetëm se ca përçartje mistike. I gjori filozof! Në gjendjen, në të cilën është katandisur, i falet kjo dërdëllitje dhe l'fapashitje prej mjerani...

-Mjaft! E kam të qartë! Ca mbroçkulla paska këputur! Kryesorja ja se ç'duhet të dimë: kemi këtu dhe dy a tre muaj jetë dhe pas kësaj na pret heshtja. Ju propozoj, zotërinj, që ta kalojmë kohën e mbetur sa më këndshëm. Për ta bërë, kërkohet një rikonceptim i jetës. Zotërinj! Ju bëj thirrje që ta mos dimë se ç'është turpi e aq më pak droja!

-Ah! Sa mirë! Hajde të mos e dimë se ç'është turpi! - u dëgjuan njëherësh disa zëra, ndër të cilët kishte dhe të rinj, ishin zërat e atyre që sapo qenë zgjuar. Për gatishmëri të veçantë u shqua basi i inxhinierit, kurse vasha Katishë kukurisi edhe më harbueshëm se në filiim.

-Ah! Sa shumë ma ka ënda që të mos turpërohem përpara asgjëje! - thirri e mbushur me galdim zemre dhe me entuziazëm Avdotia Ignatievna.

'Dëgjoni! Në dashka që të mos turpërohet për asgjë dhe kjo Avdotia Ignatievna, atëherë vaj halli të gjithë të tjerët!...

-Pse thoni kështu, Klineviç? Edhe unë kam patur turp. Po, unë atje kam patur turp! Kurse këtu dua, tmerrësisht shumë dua, që të mos kem turp për asgjë!

'Unë ju kuptoj, Kkneviç, ku doni të dilni me konstatimin tuaj,

- u dëgjua që nga vendi i tij zëri bas i inxhinierit. - Dëshironi që ta ngrini jetën e këtushme, si të thuash, mbi baza të reja, më të arsyeshme. Ju këtë synoni që të arrini?

-Mua as që më bëhet vonë, në është apo nuk është e arsyeshme kjo që ju thashë! Në dëshironi që të merrni pergjigjen e saktë për pyetjet që mund t'ju kenë lindur, prisni deri sa të zgjohet Kudejarovi, dje e sollën këtu. Me t'u zgjuar, di ai si jua shpjegon që të gjitha. Është person! Nuk është njeri, por gjigand! Në s'gabohem, nesër do të sjellin dhe një shkencëtar natyralist, sjellin dhe një oficer, kurse pas nja dy-tri ditësh do të sjellin një fejtunist, së bashku me një redaktor. Kështu më duket. Por, në drej vafshin! Edhe pa ta boll jemi të mbledhur këtu. Tani për tani më kryesore është të jem me ju i hapur. Është dëshira ime më e madhe, është gjëja më kryesore. Te jetosh në botë, zotërinj, dhe të mos genjesh është e pamundur, sepse jeta dhe mashtrimi janë sinonime. Kurse ne këtu do të qeshim, do të zgërdhijemi dhe do të argalisemi sa të duam me mashtrimin, sepse,

zotërinj, neve këtu nuk ka se ç'na duhet gënjeshtër. Se, ta marrë dreqi ta marrë, edhe varri ka një kuptim, ka dhe ai një vlerë! Do të tregojmë me zë të lartë, pa pikën e turpit e të drojës, gjithë ç'na ka ndodhur dhe do të na ndodhë, nuk do të na vijë turp për asgjë. Askush prej nesh nuk duhet të dijë se ç'është turpi, zotërinj, ç'do të thotë skuqje faqeje! Ja, kjo është e gjitha! Do të jem unë i pari që do të jap shembull, duke treguar për veten. E dini? Jam e pshor i prapë, po jam dhe demon paudhësish. Atje lart gjithçka ka qenë e lidhur me litarë të kalbur, t'i hedhim tejmatanë! Le të jetojmë këta dy-tre muaj të zhytur në të vërtetën e mirëfilltë, në atë ku mungon turpi, që nuk e njeh turpin! Hajdeni të zhvishemi! Ejani të lakuriqësohemi!

-Poshtë të fshehtat! Poshtë fshehtësitë! - thirrën që të gjithë në një zë.

-Dua të jem lakuriq! Dua të jem e mirëfilltë! Dua të tregohem ajo që jam në të vërtetë! - thirri duke i mbuluar zërat e të tjerëve Avdotia Ignatievna.

-Ah! Ah! Ah! E shoh që erdhi ora e argëtimit të madh, të shfrenuar! Nuk dua të shkoj te doktor Ekuja, as te Botkini!

-Kurse unë shkoj me shpresën se do të rroj ashtu si duhet këtë herë!...

-Hi, hi, hi, hi! - kukurisi edhe më frelëshuar Katisha.

-Kryesorja e më kryesoreve është se ne askush nuk ka si na ndalon. Ja, Pervojedovi sikur u thartua, sikur po zemërohet, por, ama, sido që të jetë, dora atij nuk i arrin dot deri tek unë. Po ju, babagjysh, a jeni dakord me ç'u tha? A do të bashkoheni me dëshirën e përgjithshme?

-Po mirë, qoftë si thoni ju të gjithë. Edhe unë dakord jam. Madje e pranoj me kënaqësi kushtin e vënë. Me kënaqësi të madhe e pranoj. Kam vetëm një dëshirë: të jetë Katisha e para ajo që do të na fiasë për veten e saj, të parë ashtu, lakuriq, - u shpreh si duke i përtypur fjalët plakushi Taraseviç.

-Jam kundër! Nuk jam në një mendje me folësin! - deklaroi I vendosur gjenerali Pervojedov.

'Lartmadhëri! - me dridhma në zë, me përgjërim e përlulësi, i foh këshilltari i oborrit Lebeziatnikovi, në mënyrë që ta kandiste gjeneralin t'i bindej dëshirës së përgjithshme. - Lartmadhëri! Po për ne, kjo që kërkohet, nuk është gjë e keqe! E pse të mos pranokemi? Ajo çupëza do të na zbaviste me ato që do të na tregonte... Na leverdis, lartmadhëri... Të shohim se ç'do të dafë... Nuk do të ndahemi të humbur.

-Po mirë. Le të bëhet ashtu si thoni ju. As në varr nuk po na lini të prehemi.

-Po pse, lartmadhëri? A nuk qetë ju që sapo lozët kumar? Pastaj, edhe në nuk doni, neve aq na bën. Do veprohet ashtu si do shumica, - ia preu shkurt Klineviçi.

-Zotëri mëshirëplotë! Ju paralajmëroj të keni mendjen! Ta mbani mirë parasysh se me kë flisni! - ia ktheu i kreshpëruar gjenerali.

-Si? Po më kërcënokeni? Po ju nuk më arrini dot! Që nga kjo largësi e bekuar mund t'ju kundërshtoj dhe, madje, edhe t'ju tall sa të më dojë qejfi, e ju asgjë nuk mund të më bëni dot... Pale pastaj zotërinj, e ç'gjeneral na qenka ky, që po na u shitka kësisoj? Atje po, atje ai gjeneral ka qenë, e kemi njohur, kurse këtu... Këtu një hiç është.

-Unë qenkam një hiç? Po a e dini se unë edhe këtu...

-Këtu ju do të kalbeni në varr! Nga ju do të mbeten vetëm ato gjashtë komçat e bakërta të uniformës!

-Të lumtë, Klineviç! Ha, ha, ha! - ushtuan disa zëra njëherësh.

'I kam shërbyer carit! Kam me vete shpatën!

-Me shpatën që keni vrisni minjtë. Aq më tepër do t'ju ketë hije ta bëni, sepse deri më sot asnjëherë nuk e keni nxjerrë nga milh.

-Thoni si të doni, por kam qenë pjesë e të tërës, pjesë e forcës.

-Po ja që pjesët e të tërës, lartmadhëri, nuk janë njëlloj! Janë të ndryshme, gjeneral!

-Të lumtë, Klineviç! Ashtu, de! Ha, ha, ha!

-Nuk e kuptoj se ç'është shpata! E përse duhet ajo këtu? - u shpreh me habi inxhinieri që nga vendi ku ishte.

-Na shkoi shtatë nga prusianët, ia mbathëm nga sytë këmbët, ikëm si minj të frikësuar! - tha me një frymë, me zë të lartë, dikush që ishte më larg të tjerëve. Sesi iu mor zëri, mend mbytej nga pezmi, tek i tha ato fjalë.

-Shpata, i nderuar zotëri, është nderi, krenaria dhe mburrja e ushtarakut! - shqiptoi me zë të fort, jo pa kryelartësi gjenerali.

Po ja që ato fjalë solemne të gjeneralit munda t'i dëgjoja vetëm unë, të tjerët nuk i dëgjuan, sepse u bë zhurmë e potere e madhe. Secili përpiqej që ta mbulonte zërin e shokut. Në atë gjullurdi u veçuan britmat çjerrëse të Avdotia Ignatievnës, e cila me një padurim të ndjeshëm tha:

-Po hë, de, ç'prisni? Kur do të fillojmë që të mos kemi turp e droje?

'Oh'oh-oh! Ashtu si thuhet, po ndodh, shpirti është duke

bërë rrugën e mundimeve! - u dëgjua zëri i një qytetari të thjeshtë. Dhe...

Dhe në këtë çast, unë... unë befaz teshtita. Ishte një gjë e papritur, e paqëflimshme, por efekti që pati ajo teshtimë ishte mahnitës: që të gjithë si me urdhër heshtën. Ajo që më ishte dukur reafitet, u zhduk, siç zhduken fanitjet e ëndrrave. Përreth mbretëroi një heshtje varri, tamam siç e përmban dukurinë vetë shprehja kuptimplote. Nuk mendoj se u erdhi turp nga unë, se u tulatën për shkak të pranisë time aty, dhe kjo për arsyen e thjeshtë, se ata që të gjithë, njëzëri, sapo e ldshin marrë vendimin që të mos turpëroheshin dhe të mos druheshin në çdo rrethanë që të gjendeshin, sido që të ishte. Prita nja pesë minuta se mos përsëriteshin zërat, por asnjë zhurmë, asnjë fërfërimë e asnjë tingull e aq më pak zë, nuk u dëgjua. Nuk kam si them se u trembën mos i spiunoja në pofici! Po pse a kishte ndonjë forcë tokësore që mund t'u bënte gjë? Me mendjen time bëra përfundimin se ata zëra përmbanin në vetvete një të fshehtë që ishte vetëm e tyre, dhe ishte një e tillë e fshehtë, që ne të vdekshmit mbitokësorë nuk e zbulonim dot, nuk jemi të aftësuar që ta bëjmë, ndërsa vetë të vdekurit taze atë e fshehin me fanatizëm.

"E po, të nderuar, do të na jepet ndonjëherë rasti që të dëgjohemi sërish," - thashë me vete dhe pa e bërë të gjatë u largova nga varreza...

Jo, jo! Unë këtë nuk kam si e pranoj! Jo dhe jo! Mua nofka dështak nuk më turbullon dot, nuk ma prish dot baraspeshën! Shturje dhe paudhësi të padëgjuara do të ketë në atë vend, ku thuhet se njerëzit prehen pas vdekjes! Dhe çfarë? Davaritje shpresash të fundit! Shturje kufomash në zgërlaqjen dhe shpërbërjen e tyre përfundimtare! Dhe si? Pa pikën e mëshirës për vegimet e fundit të vetëdijes! Ju qenë dhuruar ato pak çaste dhe prej tyre u shpërdoruan asisoj! E ku? Se vendi në këtë rast është më kryesori! Jo! Një dukuri të tillë vetëdija ime qytetare nuk ka si e pranon!...

Shkova më tej, mbajta vesh. Mirë bëra, sepse duhej dëgjuar gjithkund, nuk qe e udhës që

të mjaftohesha vetëm me një vend të varrezës, puna ma donte që përfytyrimi të ishte sa më i plotë, që dhe e vërteta të ishte sa më e pakundërshtueshme. Se ku i dihej, mund të gjeja ndonjë gjë edhe më ngushëlluese se kjo e këtushmja. Asgjë të tillë nuk gjeta. Kurse në këtë vend këtu, patjetër që do të kthehem, ju betohem që do ta mbaj fjalën e dhënë. Se këta të këtushmit u zotuan që të zbërtheheshin, që ta sfidonin turpin, ta tregonin të vërtetën lakuriq. I dëgjova me veshët e mi! Sido që të më ndodhë, do t'u vete, fjalën që po jap do ta mbaj. Shkrimin do ta shpie në gazetën "Qytetari". Do Zoti e ma botojnë.